



Datë: 12.02.2026

Numër Protokolli: 783/2026

A.nr.14/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-Kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.14/2026, të datës 09.01.2026, të parashtruar nga ankuesja H.G Fushë Kosova, kundër Shërbimit Sprovues të Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 12.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës A.nr.14/2026, të datës 09.01.2026, të parashtruar nga ankuesja H.G.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, H.G (*në tekstin e mëtejme referuar: ankuesja*), më datë 09.01.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar më numër protokolli:33/2026, kundër procedurës së rekrutimit lidhur me konkursin me Nr.reference RN00018927 për grupin shkencave shoqërore, pozita “*Zyrtar Sprovues*” të shpallur nga Shërbimi Sprovues i Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 16.01.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Sprovues i Kosovës, ndërsa ky i fundit më datë 19.01.2025 ka përcjellë përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 33/2026, të datës 09.01.2026, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin

Civil të Kosovës; Vendimin e datës 10.12.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore; Kopjen e ID-së së ankueses; Konkursin e datës 27.10.2025; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 16.01.2026; Përgjigje në kërkesë e datës 19.01.2026 me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë plotësuar parakushtet ligjore që të **përfundoj procedimi administrativ** i filluar me ankesën e ankuesit, *sepse*:

Nga analizimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Shërbimi Sprovues i Kosovës më datë 27.10.2025 ka shpallur konkursin me Nr.referencës RN00018927 për grupin shkencave shoqërore, pozita “Zyrtar Sprovues”, klasa Profesional 2, numri i kërkuar dy (2), me afat aplikimi nga data 28.10.2025 deri më datë 26.11.2025, ndërsa nga shkresat e lëndës konfirmohet fakti se në këtë konkurs, ka aplikuar edhe ankuesja.

Njësia e Burimeve Njerëzore përmes Vendimit të datës 10.12.2025, e ka refuzuar aplikacionin e ankueses me arsyetimin se e njëjta nuk e ka bashkangjitur kopjen e ID, ndërsa sipas njoftimit të datës 26.12.2025 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Shërbimin Sprovues të Kosovës, ka publikuar rezultatet përfundimtare kur rezulton se kandidatja fituese A.M ka marrë 81.2 pikë.

Ankuesja në ankesë e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 10.12.2025 për refuzimin e aplikacionit, pretendon se vendimi për refuzimin e aplikacionin është i paligjshëm me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e saj si dhe të konstatoj faktin se e ka bashkangjitur në simbnj kopjen e letërnjoftimit.

Kolegji i Këshillit duke marrë përbazë numrin e lëndëve në shqyrtim, ka konstatuar se për të njëjtin konkurs me Nr.referencës RN00018927 për grupin shkencave shoqërore, pozita “Zyrtar Sprovues” të shpallur nga ShSK, lidhur me kontestimin e procedurave të rekrutimit , me datë 29.12.2025 Këshilli ka pranuar ankesë, ndërsa me datë 06.02.2026 Këshilli ka nxjerrë Vendimin A.nr.2085/2025 përmes së cilit është aprovuar ankesa e ankueses S,G-S, ndërsa është **anulluar** Njoftimi i datës 26.12.2025, i Divizionit për Burime Njerëzore të Shërbimit Sprovues të Kosovës, lidhur më shpalljen e rezultateve përfundimtare në procedurën e pranimi më numër Reference: RN00018927, pozita Zyrtar Sprovues si dhe të gjitha veprimet administrative të ndërmarra në fazën e verifikimit paraprak dhe fazën e vlerësimit profesional, ndërsa, çështja kthehet në **rishqyrtim** të aplikacioneve të kandidatëve në këtë procedurë.

Nisur nga rrethanat e paraqitura si më lartë, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se janë plotësuar kushtet ligjore që të përfundohet procedimi administrativ lidhur me ankesën A.nr.14/2026 të datës 09.01.2026 pasi që objekti i shqyrtimit të kësaj lëndës është bërë i

pamundur apo i kotë, ngase përmes Vendimit A.nr.2085/2025 të datës 06.02.2026 Këshilli ka vendosur lidhur me këtë procedurë të rekrutimit sipas konkursit me numër reference RN00018927, ndërsa procedura në fjalë është kthyer për **rishqyrtim** në fazën e verifikimit paraprak për të gjitha aplikacionet e kandidatëve në këtë procedurë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe nën 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.14/2026, datë 12/02/2026

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses H.G;
- Shërbimit Sprovues të Kosovës (Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSCK-së.